

Lista e Dokumenteve për Regjistrim

Sigurohuni që të keni me vete sa vijon, kur të regjistroheni në shkollë.

- ☐ **Dëshmi të moshës së fëmijës** (certifikata e lindjes së fëmijës, pasaporta ose procesverbali i pagëzimit);
- ☐ **Të dhënat e imunizimit të fëmijës suaj** (nëse disponohen);
- ☐ **Raportim akademik/transkripti më i fundit i fëmijës suaj** (nëse disponohet), dhe
- ☐ **Dy (2) nga dokumentet e mëposhtme që verifikojnë adresën e banimit:**
 - ☐ Kontrata e qirasë, akti, deklarata e hipotekës për banesën;
 - ☐ Një faturë e shërbimeve të ofruara (si gazi apo elektrike), në emër të banorit/es, të lëshuar nga një kompani ofruese e këtyre shërbimeve (si p.sh. National Grid ose Con Edison) — duhet të jetë e datës brenda 60 ditëve të fundit;
 - ☐ Një faturë për shërbimet e televizionit kabllor të ofruara në banesë; duhet të përfshijë emrin e prindit dhe adresën e vendbanimit, si edhe të mbajë datën e 60 ditëve të fundit;
 - ☐ Dokumentacion apo vërtetim nga një agjenci federale, shtetërore ose vendore, duke përfshirë IRS-në, Autoritetin e Banesave të Qytetit (City Housing Authority), Zyrën Federale të Zhvendosjes së Refugjatëve (Office of Refugee Resettlement), Administratën e Burimeve Njerëzore (Human Resources Administration) ose Administratën për Shërbimet e Fëmijëve (ACS-Administration for Children Services), apo një nënkontraktor të ACS-së, duke treguar emrin dhe adresën e banorit/es — duhet të jetë e datës brenda 60 ditëve të fundit;
 - ☐ Një faturë aktuale të tatimit në pronë për banesën;
 - ☐ Një faturë uji për banesën — duhet të jetë e datës brenda 90 ditëve të fundit;
 - ☐ Një faturë qiraje (rent receipt) që përfshin adresën e banesës — duhet të jetë e datës brenda 60 ditëve të fundit;
 - ☐ Një dokument identifikimi, të lëshuar nga shteti, qyteti ose dokument tjetër identifikimi qeveritar, (përfshirë një kartë IDNYC), që nuk ka ka skaduar dhe përmban adresën e vendbanimit;
 - ☐ Formular tatimi mbi të ardhurat për vitin e fundit kalendarik;
 - ☐ Patentën Zyrtare të lëshuar në NYS ose lejë qarkullimi si praktikant/e, që nuk ka skaduar;
 - ☐ Një dokument zyrtar page (payroll documentation) nga punëdhënësi, të lëshuar brenda 60 ditëve të fundit, si p.sh. një kupon page (pay stub) me adresën e banimit, një formular për mbajtjen e tatimit në burim, ose një faturë page (payroll receipt) (një letër në letrën me logon e punëdhënësit nuk është e mjaftueshme) — duhet të përmbajë adresën e shtëpisë dhe të jetë i datës brenda 60 ditëve të fundit;
 - ☐ Dokumentet e regjistrimit të votuesit/es, që përfshijnë emrin e prindit dhe adresën e vendbanimit;
 - ☐ Dokumente anëtarësimi të paskaduar, bazuar në vendbanim (si p.sh. shoqata e banorëve të lagjes), që të përfshijnë emrin e prindit dhe adresën e vendbanimit;
 - ☐ Dëshmi për kujdestarinë e fëmijës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, urdhrat e kujdestarisë apo dokumente të kujdestarisë gjyqësore; dokumentet duhet të jenë lëshuar brenda 60 ditëve të fundit dhe të përfshijnë emrin e nxënësit/es dhe adresën e vendbanimit.

Shënim për nxënësit/et me kushte jetese në banesa të përkohshme

Nxënësve/eve që banojnë në strehime të përkohshëm, siç përcaktohet nga McKinney-Vento, nuk u kërkohet të paraqesin ndonjë dokumentacion (përfshirë adresën, dëshminë e datës së lindjes dhe imunizimin) për t'u regjistruar. Shkollat duhet përkohësisht të regjistrojnë paraprakisht nxënësin/en dhe më pas të bashkëpunojnë me kontaktin DOE për nxënësit/et në strehim të përkohshëm, për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm.